# FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

# Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

## Përmbajtja


HYRJE ........ 2

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 04160 ........ 2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT ........ 5
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT ........ 6
4. PROJEKTET E INVESTIMEVE TË PROGRAMIT ........ 7
5. TË DHËNA MBI PROGRAMIN ........ 8
6. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2022-2024 ........ 9

## HYRJE

## 1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04160

| Vështrim i përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| **Rregullimi i veprimtarive në sheshet dhe tregjet vendore ose mbështetje për infrastrukturen e tregjeve, si dhe rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja.** | | |
| **Kodi i programit** | Emri i Programit | Përshkrimi i programit |
| **04160** | Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi | • Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve;<br>• Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë. |

Bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë disa nisma në drejtim të:

- Përmirësimit të kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit.
- Thjeshtimit dhe reduktimit të proçedurave administrative.
- Forcimit të bashkëpunimit institucional me qëllim promovimin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Vlen të përmenden disa nisma në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Gjithashtu kujdes i veçantë është treguar për integrimin e brezave të rinj në ekonomi dhe krijimin e mundësive për iniciativa të ndryshme.

**Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | PBA | 2022-2024 | |
| **Raport** | **Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike** | | | | | | | |
| **Bashkia Shkoder** | **Institucioni-** | | | | | | | |
| **Programi** | 4160 | **Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi** | | | | | | |
| | | | | | **Shpenzimet e Programit (000 ALL)** | | | |
| **Emri i Artikullit** | **Kodi i Artikullit** | **2019** | **2020** | **2021** | **2021** | **2022** | **2023** | **2024** |
| | | **Fakt** | **Fakt** | **Buxh. Fillest.** | **Buxh. Pritshëm** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| **Paga dhe Sigurime** | | | | | | | | |
| Paga | **600** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sigurime Shoqërore & Shëndetësore | **601** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Korente** | | | | | | | | |
| Mallra dhe Shërbime | **602** | 494 | 144 | 1,856 | 515 | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| Subvencion | **603** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Transferta të Brendshme | **604** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Transferta të Jashtme | **605** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Transferta për Familje & Individë | **606** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Shpenzime Kapitale** | | | | | | | | |
| Aktive të Paprekshme | **230** | 0 | 0 | 962 | 962 | 0 | 0 | 0 |
| Aktive të Prekshme | **231** | 543 | 0 | 1,665 | 1,665 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | | |
| **TOTALI** | | **1,037** | **144** | **4,483** | **3,142** | **1,000** | **1,000** | **1,000** |

| Komente |
| --- |
| **Programi 04160: Sherbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi,** ka si burim financimi transferten e pakushtëzuar dhe të ardhurat e bashkisë. Mbulimi i shpenzimeve për 3 vitet mbulohen nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e bashkisë. Për vitin 2022-2024 shpenzimet korente zënë 100 % të shpenzimeve totale. |

## 2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

**Tabela 2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit**

**POLITIKA E PROGRAMIT**

| | |
|---|---|
| **Programi Buxhetor Afatmesëm** | **2022-2024** |

| | | |
|---|---|---|
| **Programi** | **04160** | **Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi** |

**Përshkrimi i Programit**

• Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturen e tregjeve;
• Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë. | | | |
| | Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi | **2021 Buxheti** | **2022 Plani** | **2023 Plani** | **2024 Plani** |
| | Numri i tregjeve funksionale në territorin e Bashkisë Shkodër | 4 tregje | 4 tregje | 4 tregje | 4 tregje |
| **1.1.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Përqindja e njësive të tregjeve publike funksionale të mirëmbajtjes se në raport me totalin | 52% | 52% | 52% | 52% |
| | Investimet bashkiake për ndërtimin tregjeve.<br>- ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 0% | 0% | 0% | 0% |

| Kryetari i NJVV | | Kordinatori i GMS | | Drejtuesi i Programit | |
|---|---|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri: | | Emri Mbiemri: | | Emri Mbiemri: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Datë: | | Datë: | | Datë: | |

## 3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

**Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT** | | | | |
| | **Programi Buxhetor Afatmesëm** | **2022-2024** | | | |
| | **Programi** | **04160** | **Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi** | | |
| **1.1.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | |
| **1.1.A.** | **Produkti** | Mirëmbajtja e njësive të tregjeve publike ekzistuese (pagesë e shërbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04160.O1.A1 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | | | |
| | Njësia Matëse | Numër vende shitje që mirëmbahen | | | |
| | | **2021 Buxheti** | **2022 Plani** | **2023 Plani** | **2024 Plani** |
| | Sasia | 120 | 120 | 120 | 120 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 500 | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 4.2 | 8.3 | 8.3 | 8.3 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.0% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | 100.0% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | 100.0% | 0.0% | 0.0% |

| **Kryetari i NJVV** | | **Kordinatori i GMS** | | **Drejtuesi i Programit** | |
|---|---|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri: | | Emri Mbiemri: | | Emri Mbiemri: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Datë: | | Datë: | | Datë: | |

## 4. Projektet e Investimeve të Programit

**Tabela 4 Projektet e Investimeve të Programit**

**PBA 2022-2024**

(000 ALL)

**Projektet e Investimeve**

| | |
|---|---|
| **Bashkia Shkoder** | **Institucioni -** |

| | | |
|---|---|---|
| **Programi** | 4160 | **Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi** |

| Kodi Projektit | Emri i Projektit | Kosto Totale e Projektit | Burimi i Financimit | Data Fillimit | Data Përfund. | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Fakti | Fakti | Buxheti | Plani | Plani | Plani |
| **1410369** | Ngritja e tregjeve ditore, zbatimi i projektit nëpërmjet rregullimit të sinjalistikës, vijëzime dhe shërbime të tjera mbështetëse | 2,208 | Fondet e veta | 2017 | | 543 | | 1,665 | | | |
| **1410824** | Tregu rajonal i peshkut | | Fondet e veta | 2021 | 2021 | | | 962 | | | |
| | **Totali** | **2,208** | | | | **543** | **0** | **2,627** | **0** | **0** | **0** |

# 5. Të Dhëna mbi Programin

**Tabela 5. Të dhënat e Programit**

**Të Dhëna Bazë mbi Programin**

| | Të Përgjithshme | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **Të dhënat e programit/ Vitet** | | | | | | |
| Numri total i vendeve të shitjes në tregje publike | | 230 | 230 | 230 | 230 | 230 |
| Numri i vendeve të shitjes në tregje publike të mirëmbajtura (pagesë e shërbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) | | 120 | 120 | 120 | 120 | 120 |
| Numri i tregjeve funksionale publike | | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 |
| Popullsia totale e bashkisë | | 209,542 | 210,182 | 210,182 | 210,182 | 210,182 |
| Investimet bashkiake për ndërtimin tregjeve në mijë lekë | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

## 6. Projektet e planifikuara për PBA 2022-2024

**Tabela 6 Emërtimet e aktiviteteve**

| **Projekte të planifikuara** | | | *000/lekë* |
|---|---|---|---|
| **Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit** | **Buxheti 2022** | **Buxheti 2023** | **Buxheti 2024** |
| P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| P04160.O1.A2. Tregu rajonal i peshkut | 0 | 0 | 0 |
| P04160.O1.A3. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | 0 | 0 | 0 |
| P04160.O1.A4. Ndërtimi i tregut të shitjes me pakicë të produkteve agro-ushqimore lokale | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | **1,000** | **1,000** | **1,000** |

| Nr.1 | **P04160.O1.A1**<br>Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**N/Funksioni 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04160**: Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Tregjet ekzistuese dhe ato të rejat që do ndërtohen e kanë të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre, sepse ato amortizohen. Sot ka tregje pa asnjë mbrojtje nga moti, pa tezga shitjeje, dhe akses të dobët si për blerësit ashtu edhe për shitësit. Edhe ambientet më të organizuara janë shumë të vogla për të mbuluar fluksin ekzistues të prodhimit. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambienteve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukturën e tezgave, banakëve, lyerje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetet dhe këmbësoret gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje në banjo publike, eletricitet, ujë etj. Riparime në ambjentet e magazinimit të mallit etj.
Tarifat kundrejt përdorimit të hapsirave të tregtimit, duhet të përdoren edhe për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes.

Bashkia Shkodër, duke zotëruar pronën, terrenin, planifikon të vlerësojë mundësinë e zhvillimit të pronës, përmes ndërtimit të një qendre tregëtare, ndërtim që mund të realizohet përmes angazhimit të bizneseve të interesuara në një investim të tillë.
Pas vlerësimit teknik të mundshmërisë së realizimit, bazuar në sipërfaqen ndërtimore të lejuar dhe koefiçientin e ndërtimit, sipas planit të përgjithshëm vendor, mund të ftohen për aplikim përmes një procedure konkurimi, bizneset ndërtuese të cilat mund të ofrojnë kapacitetet e tyre njerëzore dhe teknike dhe financiare, duke shprehur kësisoj interesin për të investuar, dhe njëkohësisht atë çfarë ato kontribuojnë për Bashkinë Shkodër. Në sajë të këtij investimi, Bashkia Shkodër mund të përfitojë hapësirë tregëtimi (tregje) në standart, duke plotësuar edhe kërkesën për hapësira tregëtimi. Nevoja për zgjerimine kapaciteteve të tregëtimit, dhe përmirësimi I standartit mbetet një nevojë që vijon të jetë akoma sfidë për ne.
Kështu, bazuar në pikën e/1) të nenit 54 të igjit 139/2015, këshilli bashkiak miraton dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private.

**ii. Synimi i projektit**

- Një infrastrukturë e përmirësuar e tregjeve do të ndihmonte veçanërisht në përmirësimin e kushteve tregtimit, rritjes së kënaqësisë së blerjes, përmirësim të higjenës dhe reduktimin e mbeturinave.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Evidentim i nevojës për mirëmbajtjen e tregjeve;
- Shërbime të mirëmbajtjes dhe riparime të domosdoshme për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit.

**b) Rezultatet që prisni**

Tregje funksionale sipas standarteve dhe që plotësojne kushtet e tregtimit të lirë.

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Fermerët | Bashkia shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Siguri me | Opera tive | Transf erime | Kapita le |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | **700** | | | 700 | | |
| A.2 | Pagesat e shërbimeve me të tretë (energji elektrike dhe ujë). | **300** | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | **1,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2023** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Siguri me | Opera tive | Transf erime | Kapita le |
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | **700** | | | 700 | | |
| A.2 | Pagesat e shërbimeve me të tretë (energji elektrike dhe ujë). | **300** | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | **1,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali ( mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Siguri me | Opera tive | Transf erime | Kapita le |
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | **600** | | | 600 | | |
| A.2 | Pagesat e sherbimeve me te tretë (energji elektrike dhe ujë.) | **400** | | | 400 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | **1,000** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Gjatë vitit 2022, 2023, 2024 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e përmirësimit të Klimës së biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br>Drejtoria e shërbimeve Publike<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 2 | **P04160.O1.A2**<br>Tregu rajonal i peshkut | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**N/Funksioni 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04160**: Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit per ndërtimin e tregjeve del e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtim të produkteve të akuakulturës.Tregtaret po shesin prodhimet e akuakulturës në kushte jo të favorshme ndërkohë që në qytetin tone është shtuar me ritme te shpejta konsumimi i peshkut të detit dhe atij të liqenit. Për të përmbushur nevojen konsumatore peshku po kultivohet në rezervate dhe vaska gjithashtu. Në qytet gjenden me dhjetra tregtate që ushtojnë aktivitetin e tyre në kushte aspak të përshtatshme. Ndyshimi në sjelljen konsumatore po sjell nevojën për pajisje magazinimi të rregullta, brenda kushte higjeno-sanitare dhe madje frigoriferike.
Të gjitha këto kërkesa kanë sjellë zhvillimin e mëtejshëm të industrisë perpunuese, por për këtë fluks të prodhimeve të akuakulturës duhet të ketë edhe një treg rajonal të mirëmenaxhuar.
Teorikisht peshku duhet të shitet sa më afër origjinës së tij.Tregu i peshkut do ishte mirë të kishte një lokacion diku afër liqenit, si burimi kryesor i peshkimit në Shkodër.
Bashkia Shkodër duke qënë një zonë bregdetare dhe liqenore njëkohesisht, e ka të domosdoshëm ndërtimin e një tregu rajonal peshku. Një treg sipas standarteve higjeno-sanitare, me tenda, me banakë për tregtimin e peshkut me higjene. Të këtë dhe kushte frigoriferike për ruajtjen e peshkut të veçantë që nuk vjen gjallë tek ne në treg.Të ndërtohen basene të vegjël për mbajtjen e peshkut që tregtohet i gjallë. Të ketë eletricitet, ujë të pijshem, sistem të rregullt kanalizimesh për qarkullimin e ujit gjithashtu dhe një vend të veçantë për grumbullimin e mbeturinave, ku ka nevojë për një pastrim jo vetëm 1 herë në 24 orë, por më shumë. Sidomos, gjatë orareve të fluksit të shitjes.
Tregu të ketë shërbime të domosdoshme, hapësira të mjaftushme për lëvizjen e automjeteve dhe për parkimin e tyre.Tregu duhet të ketë personel për menaxhim dhe për pastrim e mirëmbajtje. Të ketë zyra për personelin të shoqëruara me shërbime mbështetëse dhe banjo publike.
Ndërtimi i tregut rajonal është një proces kompleks, që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plotë financiar. Përdoruesit e këtyre ambienteve dhe kushteve për funksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim . Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimi me furnizuesit, transportuesit, tregtaret, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.
Pikërisht në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkoder për zhvillimin ekonomik duhet bërë planifikim për ndërtimin e tregut rajonal të peshkut për të zhvilluar tregti sipas formave të standartizuara. Ndërtimi i tregut rajonal të peshkut ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve jane më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standartizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të bashkisë Shkodër.
Bashkia Shkodër do të kërkojë ndihmën e Ministrisë së linjës duke kërkuar financimin e kësaj vepre.

**ii. Synimi i projektit**

- Ndërtimi i tregut rajonal te peshkut me vende tregtimi te mirëstrukturuar dhe i mirëmenaxhuar.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë:
- Vlerësim fizibiliteti
- Aktivitete parapërgatitore
- Aplikim për Fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU
- Ndërtimi i ambjenteve të tregut
- Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse si rrugë, vende parkimi, energji elektrike, kanalizime etj

**b) Rezultatet që prisni**

- Ndërtim i tregut të ri të Peshkut

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregtisë<br>Ministria e Bujqësisë<br>AZHBR | Bashkia Shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022; 2023;2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hartimi i projektit teknik | | | | | | |
| A.2 | Zbatim i projektit | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.3 | Supervizim | | | | | | |
| A.4 | Kolaudim | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Gjatë vitit 2022, 2023,2024 | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër | | | | | |

| Nr.3 | **P04160.O1.A3.**<br>Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**N/Funksioni 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04160**: Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Velipoja është një ndër qëndrat më të rëndësishme të turizmit bregdetar, gjithësesi mungojnë tregjet dhe nuk janë në kushte cilësore përsa i përket pastërtisë dhe shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit. Përgjatë sezonit të verës në këtë njësi administrative kemi praninë e shumë vizitorëve dhe turistëve, të cilët përveq shërbimeve turistike kanë edhe nevoja për të konsumuar produkte të ndryshme, të cilat duhet të tregtohen në ambientet e posaqme. Rrjeti i tregtisë në bashkinë Shkodër duhet të plotësohet me tregjet lokale të shpërndara në njësitë administrative, ku do të promovohet zhvillimi ekonomik lokale veçanërisht në zonat turistike dhe bujqësore të populluara si Shkodra (të paktën nga një treg për njësi) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0km.

Popullsia e përhershme në plazhin e Velipojës është rritur dukshëm duke arritur nga 387 në vitin 1990, në 2 075 banorë në 2016. Në vitin 2005 gjatë periudhës së verës, numri i pushuesve arrinte në 80 000, sipas statistikave gjatë vitit arrijnë mesatarisht deri në 100 000 pushues në fundjavat e pikut të sezonit. Duke marrë parasysh sasinë e lartë të produkteve të konsumuara si dhe nevojën për një mjedisi të përshtatshëm për tregtim, nevoja për ndërtimin e tregut është shumë e madhe. Duke qënë një zonë e cila ka edhe karakteristika bujqësore si dhe të shfrytëzimit të akuakulturës dhe peshkimit, impakti i ndërtimit të një tregu me hapsirat e përshtatshme të magazinimit e tregtimit, do të jetë shumë i lartë edhe në zhvillimin ekonomik. Krijimi i tregut të formalizuar ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve është me efektiv, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standartizim të ekonomive rurale me sistemin ekonomik të bashkisë Shkodër.

Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks, që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar. Përdoruesit e këtyre ambienteve dhe kushteve përfunksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim. Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimi me fermerët, furnizuesit, transportuesit, tregtaret, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.

Bashkia Shkodër do të kërkojë ndihmën e Ministrisë së linjës duke kërkuar financimin e kësaj vepre.

**ii. Synimi i projektit**

- Formalizimi i tregtimit te shitjes me pakicë në njësinë administrative Velipojë dhe sigurimi i kushteve te pershtatshme te tregtimit:
- Mbështetja prodhuesve vendas te bujqësisë, peshkimit dhe akuakulturës, rritja e tregtimit të produkteve si dhe siguria ushqimore.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë:
- Vlerwsim fizibiliteti
- Aktivitete parapërgatitore
- Aplikim për Fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU
- Ndërtimi i ambjenteve të tregut
- Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse si rrugë, vende parkimi, energji elektrike, kanalizime etj,ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike

**b) Rezultatet që prisni**

- Ndërtim i një tregu të ri të shitjes me pakicë të produkteve lokale të njësisë administrative Velipojë

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e bujqësisë, Azhbr<br>Universiteti i Shkodër<br>FSHZH | Bashkia Shkoder |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2022** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferim e | Kapitale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Hartimi i projektit teknik | | | | | | |
| A.2 | Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2023** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.2 | Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Gjatë vitit 2022, 2023 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

<table>
<tr><td>Nr.4</td><td colspan="4">P04160.O1.A4<br>Ndërtimi i tregut të shitjes me pakicë të produkteve agro-ushqimore lokale</td><td colspan="5">Funksioni 4: Çështje ekonomike<br>N/Funksioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>Programi 04160: Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi</td></tr>
<tr><td colspan="10">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</td></tr>
<tr><td colspan="10">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="10">Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve del e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtimin me pakicë të produkteve bujqësore e blegtorale. Fermerët/tregtarët të cilët shesin produktet e tyre sezonale në kushte jo të favorshme duhen mbajtur parasysh për tu zgjidhur, pasi edhe kërkesat e tyre janë të shumta për përcaktim të një vendi stabël me kushte të përshtatshme tregtimi. Në territorin e Bashkisë Shkodër, në qytet janë evidentuar rreth 450 fermerë/tregtarë informal që kane nevojë për sistemim në një vend të përshtatshëm tregëtimi. Gjithashtu, në Nj.A. e Bashkisë Shkodër ka kërkesë të vazhdueshme për ngritjen e një tregu për produktet vendase. Ndërtimi i Tregut Agroushqimor në qytet apo dhe në Nj.A., si një treg shumë-funksional dhe modern, i cili respekton ambientin dhe është në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore, gjithashtu rrit potencialin prodhues të sektorit bujqësor.<br>Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks, që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar.<br>Në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkoder për zhvillimin ekonomik po bëhet planifikimi për ndërtimin e një tregu të shitjes me pakice për produkte lokale agroushqimore për të zhvilluar tregti të formave të standardizuara. Krijimi i tregjeve të formalizuara ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standardizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër.<br>Bashkia Shkodër do të kërkojë ndihmën e Ministrisë së linjës duke kërkuar financimin e kësaj vepre.</td></tr>
<tr><td colspan="10">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">• Formalizimi i tregtimit të shitjes me pakicë në territorin e Bashkisë Shkodër dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të tregtimit nëpërmjet ngritjes së tregut sipas standardeve.</td></tr>
<tr><td colspan="10">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">• Analiza e prodhimit aktual dhe të ardhshëm të fruta-perimeve;<br>• Analiza e fluksit të tregtimit të prodhimeve ekzistuese;<br>• Analiza e infrastrukturës ekzistuese të tregjeve dhe evidentimi i nevojës<br>• Hartimi i projektit teknik për ndertimin e tregut të shitjes me pakicë.<br>• Ndërtimi i tregut në të shitjes me pakicë<br>• Mbikqyrje<br>• Kolaudimi</td></tr>
<tr><td colspan="10">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="10">• Ndërtimi i tregut Agroushqimor për produktet vendase<br>• Rritje e sigurisë ushqimore<br>• Rritje e kënaqësinë së konsumatorëve</td></tr>
<tr><td colspan="6">c) Aktorët e mundshëm</td><td colspan="4">d) Kontributet e mundshme në projekt</td></tr>
<tr><td colspan="6">Bashkia Shkodër</td><td colspan="4">Bashkia Shkodër</td></tr>
<tr><td colspan="10">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet</td><td rowspan="2">Totali (mijë lekë)</td><td colspan="7">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td colspan="2">Operative</td><td colspan="2">Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Projektimi</td><td></td><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
<tr><td>A.2</td><td>Ndërtimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i Tregut</td><td></td><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td></td><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">f) Periudha e zbatimit<br><br>Gjatë vitit 2022, 2023, 2024</td><td colspan="8">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br><br>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</td></tr>
</table>